



Viti i VIII-të i Botimit, Nr.1,
Korrik 2017

PËRDORIMI I EMRAVE E PËRVEÇËM TË HUAJ NË GJUHËN SHQIPE

Elona Limaj

Departamenti i Edukimit dhe Anglishtes, Albanian University, Tiranë, Shqipëri

Adresë kontakti: e_limaj@yahoo.com

Përmbledhje

Në kuadër të hapjes me vendet e botës dhe të kontakteve të shumta ekonomike, politike, sociale në vitet e fundit, shqiptarët janë bombarduar me një numër të madh emrash të përveçëm të huaj, të cilët si shkruhen e shqiptohen diku, nuk shkruhen e shqiptohen diku tjetër.

Kjo dukuri nuk përfshin vetëm emrat e shfaqur rishtazi, por edhe emrat e përdorur më hershëm në gjuhën shqipe. Vihet re një praktikë e re e të shkruarit dhe të shqiptuarit të këtyre emrave, që është në kundërshtim të plotë me parimin fonetik të të shkruarit të gjuhës standarde, të vendosur nga Kongresi i Drejtshkrimit.

Në këtë kuadër, aktualiteti i këtij punimi është edhe më i dukshëm, pasi ka ardhur koha që ta ndryshojmë këtë realitet.

Është fare e lehtë të gjesh shembuj të këqij, por duhet pohuar se folësit publik të medieve janë në ballë të këtij problemi, por ky problem haset në drejtshkrimin e emrave të përveçëm ndërkombëtarë në media, emrat e aktorëve, librat e përkthyer në gjuhën shqipe, filmat e përkthyer, emrat e huaj të fëmijëve shqiptarë, etj.

Duket se është krijuar pak rrëmujë në këtë pikë dhe nuk ka një tendencë të vetme të qartë për drejtshkrimin e emrave të përveçëm të huaj në shqip, gjë që sjell edhe çoroditje tek njerëzit, pasi gjuha ka lindur dhe ekziston si mjet komunikimi i lirshëm dhe gjuha e shkruar po nuk u kuptua nga lexuesi, atëherë nuk e luan dot rolin e saj.

Ky punim është realizuar duke u bazuar në shembujt e marrë në medien shqiptare të shkruar dhe audiovizive, portalet e ndryshme dhe libra të përkthyer në gjuhën shqipe.

Kemi përdorur metodën krahasuese për të kryer një analizë të plotë të dy qasjeve të përmendura në këtë punim në lidhje me emrat e përveçëm: përdorimin si në origjinal ose përkthimin e tyre.

Në drejtshkrimin e emrave të përveçëm të huaj në gjuhën shqipe përgjithësisht, ekzistojnë dy qasje, të cilat analizohen në këtë punim.

Fjalë çelës: *gjuha shqipe, drejtshkrimi, emra të përveçëm të huaj, origjinal, përkthim.*

FOREIGN PROPER NAMES IN THE ALBANIAN LANGUAGE

Abstract

In the framework of openness to the world and numerous economic, political and social contacts faced in the last years, Albanians have come across to a significant quantity of foreign proper names, who are registering different ways of writing in various cases.

This phenomena does not only include the recently appearing names, but also the proper names that has appeared earlier in the Albanian language. There is a new practice in the writing and pronunciation of these names, which runs counter to the phonetic principle of the Standard Language writing, determined by the Orthography Congress.

In this framework, the actuality of this paper is also more tangible, because it is high time to change this reality.

Bad examples can be easily found, but we must admit that media public speakers are the first to blame. Hence, this problem is noticed in the writing of the international proper names of personalities, actors names, characters of books translated into Albanian, protagonists of the movies translated into Albanian, foreign names of Albanian children, etc.

There is some confusion at this point and there is no clear rule in the writing of foreign proper names in the Albanian language. Such situation is really confusing also for common people, because language is a mean of communication, and if the written language is not understandable by readers, it cannot play its role.

This work has been realized based on examples extracted from the Albanian printed and visual media, various portals and novels translated into the Albanian language.

We have used the comparative method to carry out a complete analysis of two approaches: their usage as in the original and their translation.

This work analysis two approaches used in the Albanian language about the writing and reading of foreign proper names.

Key words: *Albanian language, writing, foreign proper names, original, translation.*

Hyrje

Që në krye të herës duhet të pranojmë se ritmet e globalizmit e kane turbulluar keqazi regjimin e gjuhës shqipe.

Në këtë epokë globalizmi të pashmangshëm të hapjes fatlume të qarkullimit me të mira e me të këqija, është e vërtetë që shqipja po jeton të njëjtat ethe si edhe vetë folësit e saj në përballjen me kulturat, qytetërimet, zakonet e gjuhët e tjera.

Nga njëra anë kjo tregon se gjuha shqipe, fort e izoluar për disa dekada, ashtu sikurse dhe aparati i mendimit njerëzor shqiptar, nuk ishte në gjendje të përballonte dyndjen, shpeshherë pa rend e pa kronologji të koncepteve, të ideve, të teknologjive.

Duhet të rikujtojmë që emrat në gjuhën shqipe ndahen në të përveçëm dhe të përgjithshëm.

Emra të përgjithshëm quhen emrat që tregojnë qenie ose sende të të njëjtit lloj.

Emra të përveçëm quhen emrat që tregojnë një qenie ose një send të vetëm, të dalluar nga të gjithë të tjerët. Drejtshkrimi i këtyre të fundit ka pësuar ndryshime me kalimin e kohës.

Dikush e shkruan emrin e huaj siç shqiptohet, dikush tjetër, siç është në origjinal. Madje në të njëjtin botim ose lajm në media mund të hasim në dy standarde të drejtshkrimit të emrave të përveçëm. Ndodh që emri e një personi të shkruhet sipas rregullave të shqipes, ndërkohë që mbiemri mbetet si në origjinal.

Ky fenomen po zhvillohet nën shurdhmemecërinë e gjuhëtarëve dhe kësaj nuk gjen asnjë bazim shkencor në këtë rrugëtim.

Metodologjia

Ky punim është realizuar duke u bazuar në shembujt e marrë në medien shqiptare të shkruar dhe audiovizive, portalet e ndryshme dhe libra të përkthyer në gjuhën shqipe.

Kemi përdorur metodën krahasuese për të kryer një analizë të plotë të dy qasjeve të përmendura në këtë punim në lidhje me emrat e përveçëm: përdorimin si në origjinal ose përkthimin e tyre.

Në nëntor 1972 u mbledh Kongresi i Drejtshkrimit, i cili gjithë vëmendjen ia kushtoi njehsimit të drejtshkrimit të gjuhës shqipe. Kongresi vendosi që në rregullat e drejtshkrimit të kombinohej parimi fonetik me atë morfologjik dhe historik.

Kongresi i vitit 1972 (1) vendosi që “*Shkrimi i emrave të përveçëm të huaj mbështet përgjithësisht në shqiptimin e tyre në gjuhët përkatëse duke iu përshtatur sistemit grafik të shqipes*” (fq. 35). Dhe jepet gjithashtu varianti që mund të shënohet në kllapa në gjuhën origjinale.

Ndërkohë, Shqipëria e viteve '90 pësoi ndryshime rrënjësore në sistemin politik, ekonomik, social e kulturor, duke u përballur me një fenomen të ri: fenomenin e globalizimit.

Pas viteve '90 kemi një vërshim të fjalëve të huaja, përfshirë emrave të përveçëm në shkrimet politike, letrare, ekonomike nga gazetatat, televizionet, radiot, konferencat, ku vihet re një shkelje gjuhësore në të gjitha rrafshet, kryesisht në drejtshkrimin e drejtshqiptimin e këtyre emrave të përveçëm.

Disa e justifikojnë këtë praktikë me numrin e madh të emrave të përveçëm të huaj që hyjnë në gjuhën shqipe të cilët janë të vështirë për t'u shqiptuar.

Pas Luftës së Dytë dhe sidomos pas Kongresit të Drejtshkrimit u përcaktuan dhe u përdorën kritere të njehsuara edhe për shkrimin e fjalëve të huaja: “Parimi themelor i drejtshkrimit të shqipes është parimi fonetik: në përgjithësi fjalët dhe pjesët e tyre të kuptimshme shkruhen ashtu siç shqiptohen në ligjërimin letrar”. Pra, mbi këtë parim dhe rregullat e dala prej tij “u detyruam” të shkruajmë për vite me radhë.

Por e keqja më e madhe është se as ky kriter nuk ndiqet me konsekuencë, prandaj edhe konfuzioni është më shqetësues. Brenda një numri gazete ose reviste, madje brenda një shkrimi, autorët shkruajnë edhe Clinton, edhe Klinton, edhe Clinton-it, edhe Clintonit; edhe “rugët e Londrës dhe të New-York-ut”.

“Presidenti amerikan në largim Barack Obama është në qytetin e Çikagos ku do të mbajë fjalimin e lamtumirës.” Ky është një shembull ku mund të gjejmë edhe lënien si në origjinal, ashtu edhe përkthimin e emrave të përveçëm në një fjali.

Gjuha është sistem dhe si i tillë nuk mund të luhet me të sipas tekave të njërit ose tjetrit. Nëse norma që kemi, për këtë ose atë kategori fjalësh ose për këtë ose atë fushë të përdorimit të gjuhës, është e ngushtë, e tejkualuar ose jointegruese, atëherë gjuhëtarët të vendosin norma e kritere të reja që duhet të zbatohen nga të gjithë ata që shkruajnë shqip.

Meqenëse në shqip emrat shquhen me mbaresë dhe lakohen, ndryshe nga shumë gjuhë të tjera të

botës, atëherë emrat e huaj s'kanë si përjashtohen nga natyra e shqipes, prandaj duhet të shquhen e të lakohen, përndryshe do të kemi një shpërftyrim të ligjëritimit shqip.

Si ka mundësi që rregulli i Kongresit të Drejtshkrimit po shkelet në të gjitha rastet e mundshme? Ekzistojnë disa qëndrime lidhur me këtë çështje dhe në këtë punim do mundohemi të paraqesim të gjithë problematikën dhe pikëpamjet mbi këtë dukuri.

Kështu, në drejtshkrimin e emrave të përveçëm të huaj në gjuhën shqipe ekzistojnë dy qëndrime.

1. Emra të përveçëm të huaj si në origjinal

Ky qëndrim konsiston në shkrimin sipas grafisë në gjuhën dhënëse, pra emrat e përveçëm të huaj në gjuhën shqipe i lëmë si në origjinal.

Në shumë vepra letrare të përkthyer para Luftës së Dytë Botërore, emri i autorit shkruhej si në origjinal, si për shembull: Shakespeare. Ndryshe veprohej me emrat e personazheve. Ato ose mund të shkruheshin si në origjinal ose mund të shkruheshin fonetikisht, si për shembull: Oliver Tuistin ose Oliver Twist-in.

Ndërkohë, këto vitet e fundit është vënë re kthimi i tendencës së periudhës para Luftës së Dytë Botërore, ku tashmë po mbizotëron shkrimi i emrave të huaj të përveçëm si në origjinal. Por nuk është çudi fare që të marrim në dorë një libër të përkthyer të një autori të huaj ku të gjithë emrat e përveçëm janë si në origjinal dhe një libër tjetër të po të njëjtit autor, por të përkthyer nga një përkthyes tjetër ku emrat e përveçëm janë shkruar fonetikisht.

Vitet e fundit në shqipen e shkruar po theksohet me të madhe prirja për t'i shkruar emrat e huaj ashtu siç shkruhen në origjinal. Për shembull: Trump, Versailles, Charles De Gaulle, Pierre-Auguste Renoir, Dwight Eisenhower. (9)

Shumë nga mbështetësit e të shkruarit të emrave të përveçëm në origjinal duhet të kenë parasysh se kontakti i gjuhës shqipe me kulturën e botës nuk është pas viteve 1990. Pasi do të na duhej të rishkruanim një numër të madh emrash të përveçëm që tashmë kanë zënë vend në regjistrin e gjuhës dhe do të ishte absurde t'i ndryshonim. Kështu, do të duhej të shkruanim Newton e jo Njuton, Chopin e jo Shopen, Rutherford e jo Radhërford, Picasso e jo Pikaso, Goethe e jo Gëte, Byron e jo Bajron, Chateaubriand e jo Shatobrian, Heine e jo Hajne, etj.

Po të shkonim më tej, do të na duhet të shkruajmë në shqip edhe emrat e vendeve ashtu siç shkruhen në gjuhët e tyre origjinale. Për shembull London në vend të Londër, New York, në vend të Nju Jork, Sevilla në vend të Seviljes (dhe në këtë rast do thoshim: Berberi i Sevilla-s!), Bordeaux në vend të Bordo (dhe do thoshim p.sh: verë e Bordeaux-it!)

Shembulli tipik është mbiemri i Presidentit Trump, i cili sheh një numër të ndryshëm drejtshkrimesh : Trump, Tramp, Trump-it. Pastaj nuk duhet të harrojmë se jo të gjithë shqiptarët dinë gjuhë të huaja e mund t'i lexojnë ashtu siç duhet emrat e huaj të shkruara në shqip si në origjinal. Ndaj e gjithë kjo ndërmarrje është një kuturisje e kotë. Gjuha shqipe bazohet mbi parimin që lexohet siç shkruhet.

Me të drejtë gjuhëtarja Jorgaqi (8) shprehet: "... të lexosh një vepër ku, nga fillimi në fund, nuk percepton veçse personazhe me emra që u bien ndesh shprehive elementare të gjuhës sate, nuk është thjesht dhe vetëm mungesë "rendimenti" gjuhësor për lexuesin. Është edhe çështje "perceptimi" emotiv, pasi prania e tyre, në njëfarë mënyre, sikur e pengon krijimin e asaj ndjesie "njësimi" që provon shpesh lexuesi karshi personazheve..." (8: fq. 90).

2. Emra të huaj të përshtatur në shqip

Qëndrimi i dytë i përket atyre që përkrahnin mendimin se emrat e përveçëm të huaj duhet të shkruhen sipas traditës vendase duke zbatuar drejtshkrimin e shqipes, sipas shqiptimit që kanë emrat e huaj në gjuhën prej nga merren.

Gjatë periudhës së komunizmit u vu re një ndryshim i plotë në këtë drejtim. Dominoi në mënyrë të plotë shkrimi fonetik i emrave të përveçëm, ku Shakespeare njihej si Shekspiri. (6) Kjo ka bërë që emri i Shekspirit dhe autorëve të tjerë të njohur botërorë të jetë mjaft i përhapur dhe i përdorur në formën e tij fonetike në masën e gjerë të lexuesve.

Emrat e përveçëm të njerëzve dhe të vendeve të huaja shkruhen sipas shqiptimit që kanë në gjuhën prej nga janë marrë: Shekspir, Bethoven, Klinton, Sharl de Gol, Shiler, Nju-Jork, Kajro, Algjeri, Palestinë, Versajë etj.

Po të shohim fillimet e shqipes së shkruar, do të vinim re se autorët e hershem shqiptarë, si Pjetër Budi, e shkruajnë emrin e birit të Zotit, Krisht e jo Christ. Më pas Noli, shkruan Shekspir e jo Shakespeare dhe Don Kishot e jo Don Quixote apo Don Quichotte.

Emrat e përveçëm i shkruajmë si shqiptohen dhe ata u nënshtrohen rregullave drejtshkrimore e gramatikore të shqipes, d.m.th. shkruhen ashtu siç dëgjohen dhe lakohen si të gjithë emrat e tjerë. Gjithsesi, mund të vendosim në kllapa emrin në origjinal. Kështu themi, Kondoliza Rajs (Condoleezza Rice), De Gol (Gaulles), Xhon Uidhers (John Withers), Cyrih (Zürich).

Disa emra të përveçëm me prejardhje të huaj të emrave të qyteteve shkruhen sipas traditës së ngulitur prej kohësh në gjuhën shqipe: Bruksel, Korfuz, Moskë, Paris, Selanik, Stamboll, Suedi, Vjenë, Zvicër, etj.

Dëgjojmë, për shembull, spikerët e TV-ve dhe të radiove si edhe gazetarët e medias së shkruar të thonë apo të shkruajnë pa të keq: “Deklarata e Trump” dhe jo “Deklarata e Trampit”; Këngëtarja britanike tërhiqet nga ceremonia e Trump; “Takimi i Ramës me Lu” dhe jo “Lu-në”; Sipas Kushner, dhe jo “Kuschner-it” etj.

Nuk është mirë të themi “Putin do takohet me Obama”, por “Putini do takohet me Obamën” pasi është e njëjta gjë sikur të thuash “Skënder do takohet me Kujtim”.

Sipas përkthyesit të shquar Shvarc (2) “Nuk duhet varrosur parimi fonetik i shqiptimit të emrave dhe duhet respektuar lakimi i emrave të përveçëm në rasi”.

Një e metë tjetër e cila haset shumë shpesh në medie, është edhe përdorimi i trajtës së pashquar në vend të së shquarës, edhe pse dihet se edhe shqipja, ashtu sikurse gjuhët e tjera të mëdha e të vjetra, ka shquarsinë dhe pashquarsinë e emrave, si dhe lakimin e tyre sipas të dyja këtyre trajtave. Vizita e Klinton fuqizon shtetin (duhet: Vizita e Klintonit fuqizon shtetin), Fjalimi i Bush i mbajtur... (duhet: Fjalimi i Bushit i mbajtur...), Xhenifer Lopez i kërkohet bashkëpunim shtesë.... (duhet: Xhenifer Lopezit i kërkohet bashkëpunim shtesë).

“Bllokohet kalimi i Lewandowskit tek Bayern shkruan një gazetë, ndërkohë që mund t’i shohim emrat e shqipëruar: bllokohet kalimi i Levandovskit tek Bajern.

Një fenomen shqetësues, për sa i përket gjuhës shqipe, është edhe dëshira e prindërve për t’u vendosur fëmijëve emra të huaj. Në shumicën e rasteve, emrat e huaj regjistrohen jo mbi bazën e rregullave të drejtshkrimit të gjuhës shqipe, po mbi ato të gjuhës së huaj nga është huazuar emri i fëmijës, të tilla si Chloe, Bryan, Wendy, Aaron, Alessio, etj. Vihen re edhe emra që mund të përdoren në të dyja gjinitë dhe është e vështirë të përcaktosh përkatësinë gjinore vetëm nga emri i zgjedhur, si Joel, Ariel, etj.

Ky fenomen shkakton vështirësi në lakimin e këtyre emrave, pasi format e tyre të huaja u përshtaten me vështirësi rregullave të shqipes.

Por çdo gjuhë ka sistemin e saj fonologjik dhe grafematik, që nuk përkon me sistemet përkatëse gjuhësore me të cilat bashkëvepron. (3)

Për këtë, ekzistojnë dy mundësi për të përshtatur emrat e huaj në gjuhën shqipe - transkriptimi dhe transliterimi.

Transkriptimi praktik gërsheton elemente të transkriptimit (pasqyrim shkrimor të fonemave) me elemente të transliterimit (dhënia e shkronjave të një alfabeti me shkronja të një alfabeti tjetër).

Parimi i transliterimit është më i përshtatshëm, ndërsa parimi i transkriptimit është i pavolitshëm në shumicën e rasteve. Parimi i transliterimit nënkupton transkriptimin fonetik që zakonisht zbatohet si transkriptim praktik. (11)

Përfundime

Unë jam e mendimit që në publicistikë dhe në letërsinë artistike është mirë që emrat e huaj të shkruhen siç shqiptohen. Në shkrimet me karakter shkencor dhe zyrtar, ose dhe kur shihet e nevojshme në një stil të posaçëm, ose në kushte të caktuara, të shkruhen në gjuhën përkatëse, duke përdorur kllapat, Simone de Beauvoir (Simon de Bovuar).

Një rrugëdalje për këtë problem mund të jetë përdorimi i vizave mes çdo emri të huaj dhe mbaresave shqipe, p.sh.: Trump-it, megjithëse, një grafi e tillë është lodhëse, jopraktike dhe të krijon përshtypjen e diçkaje artificiale, por e domosdoshme kur nuk përdoret kriteri fonetik.

Në këtë mënyrë do të mund të ndreqen edhe shqiptime të gabuara të disa emrave të huaj që, dosido, kanë hyrë në të folurit tonë.

Arsyeja është e thjeshtë: në Kongresin e Drejtshkrimit është vënë kjo rregull, e cila nuk mund të thyhet derisa të mbahet një kongres tjetër dhe të vendoset e kundërta e saj.

Fjala është për përcaktimin e një rregulle bazuar në karakteristikat e gjuhës shqipe për futjen e emrave të huaj apo fjalëve të reja.

Në fund të këtij punimi kemi ngritur disa pyetje të cilave mund të jenë objekt diskutimi në të ardhmen: Cilën metodë do të zgjidhnit ju, atë të shkruarit të emrave të përveçëm si në origjinal apo fonetik? Si mendoni, a duhet që të fillojmë të shkruajmë “Më pëlqen Shakespearë-i” apo “Më pëlqen Shekspiri”? Në qoftë se vendosim t’i shkruajmë emrat si në origjinal, çdo të ndodhë me shqiptimin e tyre kur ata të lexohen nga lexuesi që nuk e ka idenë fare se si t’i shqiptojë fjalët e huaja?

Referenca

1. Akademia e Shkencave e Shqipërisë. Drejtshkrimi i gjuhës shqipe. Tiranë; Buletin i Universitetit Shtetëror të Tiranës; 1973; 35.
2. Akademia e Shkencave të Shqipërisë Fjalor i Gjuhës Shqipe. Toena; Tiranë; 2002.
3. Shvarc, R. “Pasurimi i gjuhës shqipe në media”, 2002; Gazeta “Shekulli”; 8.
4. Lafe, E. Sistemet e transkriptimit nga gjuhët e huaja në gjuhën shqipe. 1990; Gjuha Jonë 10/4; 57.
5. Jorgaqi, K. Leksione xhepi për gjuhën. Tiranë; Dituria; 2000; 90.
6. Pipa, A. The Politics of Language in Socialist Albania. New York; Comumbia University Press; 1989; 25.
7. Qosja, R. Kongresi i drejtshkrimit – tridhjetë vjet pas, shqipja standarde dhe shoqëria shqiptare sot. Tiranë; 2003.
8. Shkurtaç, Gj. Trysnia e huaj dhe qëndresa

- e shqipes. Akte të seminarit të 3-të – Rreth huazimeve në shqipen standarde 29 prill 2004, Vol II; Nr. 1; 99-104.
9. Shkurtaj, Gj. Si të shkruajmë shqip. Tiranë; Toena; 2008; 245.

Shtojcë

Rregullat e drejtshkrimit të fjalësve me prejardhje të huaj dhe emrash të përveçëm të huaj:

- Shkrimi me -ia-, -ie-, -io-, -iu- i fjalëve të huaja që kanë -ia-, -ie-, -io-, -iu- me i të patheksuar në trup të tyre, si edhe i emrave të përveçëm të huaj të këtyre tipave. [§ 36 a]
 - Shkrimi me -ja-, -je-, -jo-, -ju- i një numri fjalës si havjar, objekt, fjord etj. [§ 36 a shën.]
 - Shkrimi ke ja-, je-, jo-, ju- i fjalëve që nisin me togjet e mësipërme, si edhe i emrave të përveçëm të huaj të këtyre tipave. [§ 36 b]
 - Shkrimi me i i fjalëve dhe i emrave të përveçëm të mësipërm, kur këto grupe janë fundore. [§ 36 c]
 - Shkrimi me j i fjalëve dhe i emrave të përveçëm me aj, ej, oj, uj, kur këto grupe janë në trup të tyre. [§ 36 c]
 - Shkrimi me i i fjalëve dhe i emrave me burim prej greqishtes së vjetër, që në këtë gjuhë kanë y. [§ 36 ç]
 - Shkrimi me i i emrave të përveçëm me burim prej greqishtes së vjetër, që në këtë gjuhë kanë y, si edhe i fjalëve të formuara prej tyre. [§ 36 ç]
 - Shkrimi edhe në gjuhën shqipe me au, eu i fjalëve dhe i emrave të përveçëm me burim grek, latin a iliro-trak me au, eu. [§ 36 d]
 - Shkrimi me v i një numri fjalësh si Evropë, nevralgji etj. [§ 36 d shën.]
 - Shkrimi me ua, ue, ui, uo i fjalëve dhe i emrave të përveçëm të burimit latin-roman me kua, kue, kui, kuo. [§ 36 dh]
10. Shkurtaj, Gj. Drejtshkrimi dhe drejtshqiptimi në mediet e sotme të shkruara dhe të folme. Tiranë; 2000.
11. Ymeri, E. Përkthimi, një histori pasioni. Tiranë; Toena; 2015; 135.
- Shkrimi në shqipen me -oo- i fjalëve të huaja me -oo-. [§ 36 e]
 - Shkrimi me ci i fjalëve me burim nga latinishtja, nga gjuhët romane, si edhe nga greqishtja, të cilat në gjuhën shqipe kanë një c të ndjekur nga e ose i. [§ 36 e]
 - Shkrimi me c i emrave të përveçëm të huaj që në gjuhën shqipe kanë një c të ndjekur nga një e ose i. [§ 36 ë]
 - Shkrimi me d, t (e jo me dh, th) i fjalëve ndërkombëtare me burim nga greqishtja e vjetër. [§ 36 f]
 - Shkrimi me d, t i emrave të përveçëm grekë e romakë. [§ 36 f]
 - Shkrimi me dh, th i një numri fjalësh dhe emrash të përveçëm të përdorimit popullor. [§ 36 f shën.]
 - Shkrimi me gj i fjalëve që burojnë kryesisht nga greqishtja, latinishtja a nga gjuhët romane e që në shqipen kanë një gj të ndjekur nga e ose i, si edhe i emrave të përveçëm të huaj të tipit të mësipërm. [§ 36 g]
 - Shkrimi me xh e jo me gj i një numri fjalësh si inxhinier, xhiro etj. [§ 36 g shën.]
 - Shkrimi me j (dhe jo me zh ose xh) i fjalëve si adjutant, juri etj. [§ 36 gj]
 - Shkrimi me zh i fjalëve që janë marrë drejtpërdrejt nga frëngjishtja. [§ 36 gj]
 - Shkrimi me gn i fjalëve si agnosticizëm, gneis etj. [§ 36 h]
 - Shkrimi me nj i fjalëve si dinjitet, linjit etj. [§ 36 h]
 - Shkrimi me h- i fjalëve që në greqishten e vjetër fillonin me zanore të aspiruar dhe në latinishten me h-. [§ 36 i]
 - Shkrimi me h- i emrave të përveçëm që në greqishten e vjetër fillonin me

- zanore të aspiruar dhe në latinishten me h-, si edhe i emrave të tjerë të përveçëm, fonetiki i të ngjashëm me ta. [§ 36 i]
- Shkrimi me k i fjalëve të terminologjisë tekniko-shkencore ndërkombëtare me burim nga greqishtja e vjetër dhe që përmbajnë tema të cilat në greqishte kanë pasur një χ, si edhe i emrave të përveçëm të huaj të tipit të mësipërm. [§ 36 j]
 - Shkrimi me ks i fjalëve që në gjuhën shqipe kanë një -ks- të ndjekur nga një -io. [§ 36 k]
 - Shkrimi me ks i fjalëve me burim grek a latin që përmbajnë elementin eks të ndjekur nga një bashkëtingëllore. [§ 36 l]
 - Shkrimi me kz i fjalëve me burim grek a latin që përmbajnë elementin eks të ndjekur nga një zanore. [§ 36 l]
 - Shkrimi me kz i fjalëve të burimit grek që përmbajnë temat ekzo a hekza. [§ 36 l]
 - Shkrimi me l i fjalëve me burim nga greqishtja e vjetër, nga latinishtja ose nga gjuhët romane dhe që në këto gjuhë kanë një l të thjeshtë ose dyfishe. [§ 36 ll]
 - Shkrimi me l i emrave të përveçëm me burim nga greqishtja e vjetër, nga latinishtja ose nga gjuhët romane dhe që në këto gjuhë kanë një l të thjeshtë ose dyfishe. [§ 36 ll]
 - Shkrimi me ll, në pajtim me shqiptimin popullor të ngulitur prej kohësh, i disa fjalëve me burim të huaj të tipit të mësipërm. [§ 36 ll shën. 1]
 - Shkrimi me l dhe me ll i fjalëve me burim nga anglishtja. [§ 36 ll shën. 2]
 - Shkrimi me l dhe me ll i fjalëve të reja të burimit sllav. [§ 36 ll shën. 3]
 - Shkrimi me rr i fjalëve të huaja, kryesisht romane, që në këto gjuhë kanë rr. [§ 36 m]
 - Shkrimi me -z- i fjalëve me burim nga greqishtja e vjetër, nga latinishtja a nga gjuhët romane ose të formuara në shqipen me elemente të këtyre gjuhëve, tek të cilat ato kanë një s ndërzanore, si edhe i emrave të përveçëm të huaj të tipit të mësipërm. [§ 36 n]
 - Shkrimi me s i një numri emrash të përveçëm të tipit të mësipërm. [§ 36 n shën.]
 - Shkrimi me -z- i fjalëve me -izëm e -azëm. [§ 36 nj]
 - Shkrimi me -zm- i fjalëve me burim nga greqishtja e vjetër ose të ndërtuara me elemente të kësaj gjuhe. [§ 36 o]
 - Shkrimi me -z- i fjalëve të huaja, të formuara me parashtesën dez- (des-), kur s-ja e parashtesës gjendet në pozicion ndërzanor. [§ 36 p]
 - Shkrimi me s i fjalëve me parashtesën dis-përpara një bashkëtingëlloreje. [§ 36 q]
 - Shkrimi me s i fjalëve me parashtesën trans. [§ 36 q]
 - Shkrimi me s i fjalëve të huaja që në gjuhën e burimit kanë ss. [§ 36 r]
 - Shkrimi me -s- i fjalëve të huaja të formuara me parashtesën a- prej fjalës me s nistore. [§ 36 rr]
 - Shkrimi i emrave të përveçëm të huaj sipas shqiptimit të tyre në gjuhët përkatëse dhe në përshtatje me sistemin grafik të shqipes. [§ 37]
 - Mosruajtja në shkrim e bashkëtingëlloreve dyfishe të emrave të përveçëm të huaj me përjashtim të rr-së. [§ 37]
 - Shënimi në kllapa, në shfaqjen e parë i emrave të përveçëm të huaj sipas grafisë së gjuhës nga burojnë. [§ 37]
 - Shkrimi me l i emrave të përveçëm të gjuhëve sllave, pavarësisht nga mënyra e shqiptimit të l-së në këto gjuhë. [§ 37 shën. 1]
 - Shkrimi me -i i emrave të përveçëm me -ij të burimit rus. [§ 37 shën. 2]
 - Shkrimi sipas traditës së ngulitur prej kohësh në gjuhën shqipe i disa emrave të përveçëm të huaj. [§ 37 shën. 3]